

V E N D I M
Nr.381, datë 26.7.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 248, DATË 27.5.1993 "PËR DISA MASA PËR SHPEJTIMIN E PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA E TË MESME"

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 10 shtohet pika 10/a me këtë përmbajtje:

"Bordi i degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në Bashkinë e Tiranës përbëhet nga personat e mëposhtëm:

1. Kryetari i degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në Bashkinë e Tiranës.
2. Kryetari i bashkisë.
3. Kryetari i këshillit të bashkisë.
4. Sekretari i bashkisë.
5. Shefi i financës së bashkisë.
6. Shefi i kontroll-revizionit të bashkisë.
7. Shefi i seksionit të tregtisë të bashkisë.
8. Shefi i seksionit të prognozës të politikës ekonomike.
9. Drejtori i drejtorisë së arsimit.
10. Drejtori i drejtorisë së shëndetit publik.
11. Kryetari i zyrës së tatimeve.
12. Drejtori i degës së Bankës Kombëtare Tregtare.
13. Kryetari i policisë financiare për Tiranën.
14. Kryetari i SHIK-ut.
15. Drejtori i Drejtorisë së Punës.
16. Drejtori i Drejtorisë së Rendit Publik.
17. Drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike.
18. Përgjegjësi i zyrës së kadastrës urbane.
19. Kryetari i dhomës së tregtisë.

Në përbërjen e bordeve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe, kryetari i degës së kontrollit të shtetit në rreth hiqet dhe zëvendësohet nga drejtori i drejtorisë së shëndetit publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi